Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-330
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 15.09.2017 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Akreditohet dhe validohet Qendra e bukurisë "Illusion Academy" në Prishtinë me adresë Rruga "Lekë Dukagjini" Prishtinë p. n për periudhën 15.09.2017 deri 15.09.2020 me kualifikimet:

   1.1. Grimer/Grimere, Niveli III sipas KKK me 17 kredi të AAP.
   1.2. Manikyrist/Manikyriste, Niveli III sipas KKK me 10 kredi të AAP.
   1.3. Parukier/Parukiere, Niveli III sipas KKK me 64 kredi të AAP.

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:

Grimer/Grimere

2.1. Programi i paraqitur në aplikacionin për profilin e grimit përfshinë 17 kredi me 170 orë dhe është i pamundur të realizohet në afatin 1 mujor që është paraqitur nga qendra si kohë e vijimit të kandidatëve në këtë profil. Afati i kursit të jetë i përcaktuar minimalisht dy muaj, kohë kjo e domosdoshme për të marrë njohuritë për nivelin e tretë të kualifikimit në profesionin e grimit.

2.2. Plotësimi i bazës materiale mbështetëse për çdo kandidat në mënyrë individuale.

2.3. Adaptimi i hapësirës në mënyrë më funksionale, që t'i jepet lehtësi kandidatëve për t'u ushtruar në pjesën praktike të profesionit të grimerit, për grupe te parashikuara me më shume se 20 kandidatë.

2.4. Qendra të pajiset me klimatizim. Kusht i domosdoshëm si për kandidatët, ashtu edhe për klientët që do marrin shërbime në këtë ambient.

2.5. Kualifikim pedagogjik shtesë i trajnerëve, apo i asistentëve, për tu aftësuar në dhënien e moduleve të qendrës profesionale "Illusion Academy", në seminare intensive brenda dhe jashtë vendit.

2.6. Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve të bëhet me përqindje, mbi 50% ana teorike dhe mbi 70% ana praktike dhe të jenë të njoftuar paraprakisht kandidatet dhe trajnerët te cilët nuk kishin informacion rreth këtyre kufijve.

2.7. Të zhvillohen mekanizma të sigurimit të brendshëm të cilësisë (si p.sh. pyetësorë anonimë për nxënësit rreth vlerësimit të stafit, masat rreth identifikimit dhe përmirësimit të rezultateve nga anketat).

2.8. Në hapësirat ku zhvillohet trajnimi në profilin e grimit, të ekspozohet dukshëm rregullorja e brendshme e etikës dhe e mirësjelljes të gjithë pjesëmarrësve në qendër.

2.9. Qendra të pajiset me orientimet e daljes emergjente dhe aparatet e fikjes së zjarrit të jenë funksionale dhe në vende të dukshme.

2.10. Data e fillimit të trajnimit për kandidatët të jetë një e vetme për një grup, pasi trajnerët janë të paktë në numër për t'u mundësuar kandidatëve fillimin në çdo kohe.

Manikyrist/Manikyriste

2.1. Ndriçimi në sallën ku kryhet kursi i manikyrit është i pamjaftueshëm. Të shtohet ndriçimi me llampa për çdo tavolinë pune.

2.2. Të gjithë trajnerët e kanë të nevojshëm të kryejnë trajnime për pedagogji dhe metodologji për të zhvilluar procesin e mësimdhënies.

2.3. Hartimi i politikave për zhvillim profesional të stafit mësimdhënës/trajnerëve në aspektin metodik dhe didaktik si dhe çertifikimi i tyre.

2.4. Organizimi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm (përfshirë në panel edhe një manikyrist/e të kualifikuar nga sektori privat).

2.5. Vlerësimi të bëhet me pikë dhe jo nota.

2.6. Të kompletohet literatura me pjesën mjekësore për çdo modul në pjesën teorike dhe praktike.

2.7. Qendra të pajiset me klimatizim, për krijimin e kushteve më të favorshme për kryerjen e mësimit.

2.8. Kualifikimi i domosdoshëm i të gjithë trajnerëve dhe asistentëve në pjesën profesionale (sidomos pjesën teorike) për të zhvilluar procesin e mësimdhënies si dhe pjesën pedagogjike.

2.9. Të jenë trajnerët me një përvojë pune më të gjatë në programin e manikyrit.

2.10. Modulet e publikuara të jenë në përputhshmëri me standardin e manikyrit dhe renditja e tyre të jetë adekuate, sipas standardit të aprovuar nga MASHT.

2.11. Trajnerët të jenë të njoftuar për modulet e programit të manikyrit, të cilën duhen ta zhvillojnë në teori dhe praktikë.

2.12. Të kompletohet literatura për pjesën teorike (pjesa anatomike e thoit dhe sëmundjet) dhe praktike në programin e manikyrit dhe të pajisen kandidatët me literaturë të qendrës.

2.13. Të ofrohet salla e praktikës me kushte më të volitshme për kandidatët (klimatizimi, tavolinat individuale të punës dhe hapësira më e madhe) për realizimin e programit të manikyrit.

2.14. Mjetet sterilizuese të jenë prezent, si antiseptikët dhe aparaturat e posaçme për sterilizimin e mjeteve te punës.

2.15. Të zhvillohet programi i manikyrit në një ambient me higjienë më të lartë se tani (ndërrimi i shpeshtë i peshqirëve pas çdo pune).

2.16. Data e fillimit të trajnimit për kandidatë të jetë një e vetme për një grup, pasi trajnerët janë të paktë në numër për t'u mundësuar kandidatëve fillimin në çdo kohë.

Parukier/Parukiere

2.1. Programi i paraqitur në aplikacionin për profilin e parukerisë përfshin 64 kredi me 639 orë afati është 6 muaj, kohë e cila nuk mjafton për të realizuar 64 kreditë e paracaktuara. Duhet të shtohet afati me 1 muaj.

2.2. Qendra të pajiset me klimatizim. Kusht i domosdoshëm si për kandidatët, ashtu edhe për klientët që do marrin shërbime në këtë ambient.

2.3. Kualifikim pedagogjik shtesë i trajnerëve/ndihmës trajnerëve për tu aftësuar në dhënien e moduleve të qendrës profesionale "Illusion Academy.

2.4. Vlerësimi përfundimtar i kandidatëve të bëhet me përqindje, mbi 50% ana teorike dhe mbi 70% ana praktike dhe të jenë të njoftuar paraprakisht kandidatet dhe trajnerët të cilët nuk kishin informacion rreth këtyre kufijve.

2.5. Të zhvillohen mekanizma të sigurimit të brendshëm të cilësisë (si psh. pyetsorë anonimë për nxënësit rreth vlerësimit të stafit, masat rreth identifikimit dhe përmirësimit të rezultateve nga anketat).

2.6. Në hapësirat ku zhvillohet trajnimi në profilin e parukerisë, të ekspozohet dukshëm rregullorja e brendshme e etikës dhe e mirësjelljes te të gjithë pjesëmarrësve në qendër.

2.7. Qendra të pajiset me orientimet e daljes emergjente dhe aparatet e fikjes së zjarrit të jenë funksionale dhe në vende të dukshme.

2.8. Data e fillimit te trajnimit për kandidatet të jetë një e vetme për një grup, pasi trajnerët janë të paktë në numër për t'u mundësuar kandidatëve fillimin në çdo kohë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datat 30.12.2017 sipas raporteve të jashtme vlerësuese për secilin kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

4. Nuk akreditohet dhe nuk validohet Qendra e bukurisë "Illusion Academy" në Prishtinë me adresë Rruga "Lekë Dukagjini" Prishtinë p. n për kualifikimin:

4.1. Estetikë, Niveli III sipas KKK me 15 kredi të AAP.

Kushtet dhe rekomandimet për mos akreditim dhe mos validim të këtij kualifikimin janë në Raportin e Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit dhe Raportin e Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

4. Vendimi u dërgohet:
- Illusion Academy;
- AKK.

Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së